



| | |
|---|---|
| REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. Dep. <u>03-02/DPK</u> | Nr Prot. Br. Prot. <u>01-1261/16</u> Prot No. |
| Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u> | Data Datum Date <u>25-03-2016</u> |
| Republika e Kosovës | |



Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.03.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4644/15, për znj. Vjosa Dobruna – Ambasadore e Kosovës në Holandë, për shkak se ajo ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4644/15, për znj. Vjosa Dobruna – Ambasadore e Kosovës në Holandë, dhe njëkohësisht pronare në biznesin privat N.P. “Intel Gr”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, zyrtarja e lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ajo ka kontaktuar zyrtarët e AKK-së.

Zyrtarja e lartë është njoftuar për situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

znj. Dobruna ka deklaruar se nuk e ka ditur se kjo situatë paraqet konflikt interesi meqenëse biznesi i saj aktualisht është pasiv, por është zotuar se do t'i bëj ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit, duke mbyllur biznesin privat.

Ndërkohë, ajo ka dërguar në AKK shkresën zyrtare nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, dëshmi me të cilën vërtetohet se e njëjta ka mbyllur biznesin privat. Me këtë zyrtarja e lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

